

MINISTRIA E KULTURËS

RAPORTET E MONITORIMIT

3 - MUJORI - VITI 2014

Programet Buxhetore:

1. Planifikim Administrim, Menaxhim
2. Trashëgimia Kulturore
3. Arti dhe Kultura

RELACION**MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË VITIT 2014**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, kreu VIII, neni 65 “Monitorimi”, të ligjit nr. 185/2013, “Për Buxhetin e vitit 2014”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” paragrafi VI “Raportet e Monitorimit” dhe Udhëzimit nr. 1/1, datë 19.02.2013 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2013”, shtojcat nr. 7-11, Ministria e Kulturës, për 3 - mujorin e vitit 2014, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore.

Me anë të këtij relacioni prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për 3 - **mujorin e vitit 2014**, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 3- mujori 2014		Realizimi 3- mujori 2014		
		Në (000) leke	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	30,558	10.00%	24,826	10.54%	81.24%
2.	Trashëgimia Kulturore	93,797	30.69%	67,084	28.48%	71.52%
3.	Arti dhe Kultura	181,240	59.31%	143,667	60.99%	79.27%
	Totali	305,595	100.0%	235,577	100.0%	77.09%
	Financimi i huaj per investime	0	0	0	0	0
	Totali me Financimet e huaja	0	0	0	0	0

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se, buxheti është realizuar në masën 77%, ku rreth 59 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 79%, ndjekur nga programi “Trashëgimia Kulturore shpenzimet e të cilit zënë rreth 31 % të totali dhe janë realizuar në masën 72%, programi “Planifikim Menaxhimi” shpenzimet e të cilit zënë rreth 10 % dhe janë realizuar në masën 81% .

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomike

G r	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3- mujori 2014		Realizimi 3- mujori I 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	221,614	72.5%	205,995	87.4%	93%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	49,816	16.3%	29,582	12.6%	59.4%
12	01110	231	Kapitale	34,165	11.2%	0	0	0
			TOTALI	305,595	100	235,577	100	77.1%
12	01110	231	Jashtë buxhetore					
			TOTALI	305,595	100	235,577	100	77.1%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se shpenzimet për 3-mujorin e I të vitit 2014 për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 93%, shpenzimet korente 59 %, shpenzimet kapitale, nuk janë realizuar fare.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i fondeve për investime si dhe nga mosrealizimi i një pjesë të shpenzimeve korrente të cilat do të analizohen për cdo program.

Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1. Programi: "PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM"

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe shpenzimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3- mujori 2014		Realizimi 3- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	21,508	70.4%	17,147	69.1%	79.7%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	9,050	29.6%	7,679	30.9%	84.9%
12	01110	231	Kapitale	0		0		0
			TOTALI	30,558	100	24,826	100	81.2%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 81%, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 70 % të totalit dhe janë realizuar në masën 80%. Shpenzimet korrente zënë rreth 30% të totalit dhe janë realizuar në masën 85%. Shpenzimet kapitale nuk janë realizuar fare.

Mosrealizimi i fondeve në masën 18.8% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale gjithashtu pa lenë pas dhe shpenzimet për paga e sigurime shoqërore.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në gjashtë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme. Sikurse vihet re nga të dhënat, konstatohet realizimi i produkteve.

në (000) lekë

Programi	Planifikim, Menaxhim, Administrim				01110
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit			
		PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 3-mujori 2014	Buxhet/Fakt 3-mujori 2014
A-01363	Ristrukturim		31,980	19,693	16,736
B-02113	Pajisje		5,000		
C-02459	Akte ligjore e nenligjore		45,980	7,260	4,840
D-02496	Nenshkrim marreveshjesh		39,389	0.0	0.0
F-04248	Auditime		10,656	2,131	1,776
E-04177	Pagesa vendimesh gjyqesore		5,895	1,474	1,474
Totali			138,900	30,558	24,826

Nga sa mësipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar pjesërisht. Në lidhje me realizimin e produkteve informojmë se procesi i ristrukturimit është kryer brenda numrit të përgjithsëm të MK-së në zbatim të Ligjislacionit në fuqi.

Për sa i përket produktit “Pajisje” nuk ka patur realizim për këtë 3 muhor.

Gjatë 3 muhorit të parë të vitit 2014 realizimi i produkti “Akte ligjore dhe nenligjore” përfajson procesin e hartimit të draftit të ligjit të ri për trashëgiminë kulturore.

Në realizimin e Produktit “Nënskrim Marrëveshjesh” gjatë 3 muhorit të parë nuk kemi patur marrëveshje të nënskruara.

Në realizimin e Produktit “Auditime” gjatë këtij 3 muhori janë kryer auditime në këto institucione: DRKK Saransë, DRKK Shkodër, Parku Arkeologjik Apolloni dhe Muzeu Historik Kombëtar.

Gjatë tre muhorit të parë të këtij viti, janë kryer pagesa vendimesh gjyqësore në masën 540.000 lekë.

2. Programi: "TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË"

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3- mujori 2014		Realizimi 3- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	67,518	72%	61,182	91.2%	90.6%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	14,114	15%	5,901	8.8%	41.8%
12	01110	231	Kapitale	12,165	13%	0		0
			TOTALI	93,797	100%	67,084	100%	71.5%
12	01110	231	Jashtë buxhetore	0	0	0	0	0
			TOTALI	93,797	100%	67,084	100%	71.5%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 72%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 72% të totalit dhe janë realizuar në masën 91%, shpenzimet korrente zënë rreth 15% të totalit dhe janë realizuar në masën 42% dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 13% dhe janë realizuar në masën 0%.

Mosrealizimi në masën 28.5 % e totalit konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale gjithashtu pa lenë pas dhe shpenzimet korrente, kryesisht mos realizim vjen si rrjedhojë e ristrukturimit të institucioneve të trashëgimisë, punimet rastauruse janë në proces si dhe aktivitetet janë në proces.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

Programi	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë					08220
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit				
		PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 3-mujori 2014	Buxhet/Fakt 3-mujori 2014	
A-00324	Banesa te restauruara		119,750	30,638	23,831	
B-00324	Muze te rikolnstruktuar dhe permiresuar ne infrastrukture		93,000	23,000	18,208	
C-00324	Objekte kulti te restauruara		41,500	8,100	4,000	
D-00324	Infrastrukture e permiresuar ne parqe arkeologjike		75,500	14,900	10,526	
F-00324	Aktivitete te trashegimise shpirtore dhe diversiteti kulturor		61,850	8,659	6,185	

G-00324	Kartela te inventarizuara		10,000	2,500	2,334
H-00324	Qendra historike/ kala historike		42,000	6,000	2,000
	Totali		443,600	93,797	67,084

Produktet e planifikuara në këtë program në përgjithësi janë realizuar

- ***“Banesa të restauruara” (punime mirmbajtje objekte monument kulture).***

Ky produkt kryesisht konsiston në mirmbajtjen, restaurimin, konsolidimin, mbrojtjen, monitorimin dhe hartimin e projekteve të restaurimit në objekte monument Kulture monumente kulture.

- **Në DRKK Berat e Durrës** janë kryer ndërhyrje mirmbajtje në 9 objekte monument kulture dhe vazhdojnë punimet në 2 objekte të tjera.
- **DRKK Durrës, Gjirokastrë, Shkodër, Korçë** janë hartuar projektet dhe kanë filluar punimet për mirmbajtjen e 3 objekteve monument kulture .

- **“Muze të Rikonstruktuar dhe përmirësuar në infrastrukturë”**

Është në proces përmirësimi i infrastrukturës si dhe rritja e standarteve për një shërbim më të mirë ndaj publikut, dhe kushteve të veprimtarisë në këto institucione kështu:

- **Muzeut Arkeologjik në Durrës**, Pas rikonstruksionit të tij, (nuk ka përfunduar akoma dhoma teknike dhe paisja e saj), po punohet për muzealizimin e tij. Specialistë të DRKK Durrës dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës po punojnë për përgatitjen për ekspozim të objekteve dhe vendosjen nëpër vitrina. Në bashkëpunim me Bashkinë Durrës punohet për sistemimin e oborrit të Muzeut dhe objekteve në pjesën e jashtme të tij.
- Pranë **Muzeut Historik Kombëtar** po punohet për hapjen e **Pavionit Etnografik**.
- **Vlerësimin** e objekteve muzeale si dhe regjistrimi i tyre pranë QKIPK.
- **Fototeka Marubi** në bashkëpunim me FSHZH ka realizuar konkursin për hartimin e projektit të zbatimit për vënien në funksionim të godinës së re të fototekës Marubi.

- **“Objekte kulturi të restauruara”**

Janë kryer mirmbajtje në kishën e **Shën Mëhillit** Berat, janë hartuar projektet dhe pritet të fillojë puna për mirmbajtjen e disa objektete të tjera në Berat, Korçë, Durrës etj

- **“Infrastrukturë e përmirësuar në Parqet Arkeologjike”**

- Parqet arkeologjike kryejnë në vazhdimësi mirmbajtjen e teritorit si pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët, konsolidim të mureve, paisjen e ambjentëve me tabela informuese etj.
- Projekti me financim të huaj në sitin arkeologjik të Apolonisë “ Restaurimi i Manastirit të Shën Marisë dhe hartimi i Master Planit” i cili do të realizohet në dy vite 2014- 2015.

- **“Aktivitete të trashëgimisë shpirtërore dhe diversitetit kulturor”**

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014 është realizuar aktiviteti “Trajnim për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të sistemit të trashëgimisë”.

Gjithashtu gjatë këtij 3 mujori janë miratuar dhe lidhur kontratat për 20 aktivitete të tjera që do të zhvillohen nga subjekte private të financuara nga zëri 604 i Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore.

Po kështu, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike ka përcaktuar dhe miratuar infrastrukturën e aktiviteteve që kjo Qendër do të zhvillojë në tremujorët e ardhshëm.

- **Kartela te inventarizuara**

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, në kuadër të projektit afatgjatë “Krijimi i rrjetit kombëtar informatik i trashëgimisë kulturore” punon për katagolimimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në fushat Arkeologjisë, Artit pamor, Etnografisë, Arkitekturës, etj.

- **Kala te rastauruara**

DRKK Durrës po kryen pastrimin në të gjithë murin e Kalasë së Durrësit, gjithashtu po punohet për një projekt ndërhyrjesh restaurimi nga IMK në disa pjesë të murit, si dhe vecanerisht në Kullen.

DRKK Berat ka kryer pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët në tre lagje të **qendrës historike (Kala, Mangalem, Goricë) dhe te Qendra Mesjtare**

DRKK Shkodër me sektorët e saj në mënyrë të vazhdueshme mirmban kalanë Rozafa, kalanë e Lezhës etj.

3. Programi: “ ARTI DHE KULTURA”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3- mujori 2014		Realizimi 3- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	132,558	73.2%	127,665	88.9%	96.3%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	26,653	14.7%	16.002	11.1%	60.0%
12	01110	231	Kapitale	22.000	12.1%	0		0
			TOTALI	181,240	100	143,667	100	79.3%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 79%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 73 % të totalit dhe janë realizuar në masën 96%. Shpenzimet korrente zënë rreth 15% të totalit dhe janë realizuar në masën 60%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 12% dhe janë realizuar në masën 0%. Mosrealizimi i fondeve në masën 20.7% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale dhe ato korrente.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

në (000) lekë

Programi	Arti dhe Kultura					08230
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit					
	Emri Produktit	PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 3-mujori 2014	Buxhet/Fakt 3-mujori 2014	
A-00325	Evidentimi, Promovimi dhe angazhimi i artisteve të rinj pranë institucioneve publike të artit		294,976	76,938	41,970	
B-00325	Realizimi i edicioneve të përvitshme ku përzgjidhen dhe vlerësohen autorët dhe krijimtaria me e mirë e vitit		200,000	50,000	50,000	
C-00325	Mbeshtetje dhe administrim i fondit publik për projektet artistike dhe kulturore		310,180	51,697	51,697	
D-00325	Ambiente të rikonstruara në institucionet publike të artit & Rritja e aksesit të publike pranë institucioneve publike të artit dhe kultures		28,664	2,606	0	
E-00325	Ndërgjegjësimi i opinionit publik dhe grupet e interesit për rolin dhe përgjegjësitë mbi respektin e të drejtës së autorit			0	0	
Totali			833,820	181,240	143,667	

Për Programin “Arti dhe Kultura”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Artin dhe Kulturën në MK, në zbatim të politikave dhe prioritetëve institucionale në këtë fushë, ka zhvilluar një mori aktiviteteve gjithëpërfshirëse në bashkërendim me institucionet qendrore të artit dhe kulturës, si dhe operatorë të tjerë të cilët zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e artit dhe kulturës në Republikën e Shqipërisë.

Lidhur me realizimin e produkteve;

- ❖ **“Thirrjen për projekt-propozime, në Art-Kulturë dhe Trashëgimi Kulturorë”, si dhe “Udhëzuesin” mbi procedurat që duhet të ndiqen, në kuadër të mbështetjes dhe administrim i fondit publik për projektet artistike dhe kulturore.**

Ministrisë së Kulturës, shpallja e fondit për projektet që do të mbështeten, bazuar në propozimet e paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt nëpërmjet konferencës për shtyp, faqes zyrtare të ëeb-site, www.kultura.gov.al, shtypit mediatik dhe atij të shkruar, e cila konsistonte në, “Thirrjen për projekt-propozime, në Art-Kulturë dhe Trashëgimi Kulturor”, si dhe “Udhëzuesin” mbi procedurat që duhen të ndiqen në të gjitha fazat e vlerësimit të tij:

Faza e I-rë, e dorëzimit të projekt propozimeve ka nisur më 15 Janar dhe përfundoi më 14 shkurt 2014.

Faza e II-të, shqyrtimi nga specialistët e fushës, për nga ana e plotësimit apo jo të dokumentacion për çdo projekt-propozim.

Faza III-të, Vendimi i Kolegjiumit i cili u konsultua dhe me ekspertë të jashtëm sipas disiplinave përkatëse, nga ku u përzgjedhën projektet fituese. Përzgjedhja e tyre u bazua në në kriteret e shpallura në udhëzuesin që shoqëroi thirrjen për projekt-propozime. Projektet e përzgjedhura do të mbështeten në mënyrë të pjesshme ose të plotë nga Ministria e Kulturës.

Faza e IV-të, shpallja e fituesve pranë ëeb-site të MK, www.kultura.gov.al

Faza e V-të, lidhja e kontratave me secilin nga përfituesit.

Në këtë kuadër, në fund të 3 mujorit të I-rë, u shpallën projektet fituese të cilat do të mbështeten nga MK, projekte të cilat do të startojnë, realizimin e tyre në muajin prill. Për këtë arsye ky fond do të fillojë procesin e lëvrimin, sipas fazave të përcaktuara në kontratat përkatëse.

Përsa i përket produktit,

❖ ***Ambiente të rikonstruktura në institucionet publike të artit & Rritja e aksesit të publikut pranë institucioneve publike të artit dhe kulturës***

Është në proces përmirësimi infrastruktura si dhe rritja e standarteve për një shërbim më të mirë ndaj publikut, dhe kushteve të veprimtarisë artistike në këto institucione.

Duke marrë në konsideratë se 3 mujori i parë, korespondon me çeljen e Buxhetit për vitin 2014, shprehemi se është në fazë startimi dhe zhvillimi konkret i këtij produkti.

❖ ***Ndërgjegjësimi i opinionit publik dhe grupet e interesit për rolin dhe përgjegjësitë mbi respektin e të Drejtës së Autorit***

Në kuadër të procesit të rishikimit të Ligjit nr.9380, Dt. 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, si dhe të ristrukturimit të institucionit të ZSHDA, përgjatë 3 mujorit të parë, të vitit 2014, ka sjell për pasojë mos realizimin e aktiviteteve të parasikuara në këtë periudhë.

❖ ***Promovimi i imazhit dhe artit shqiptar në arenën ndërkombëtare si dhe sjellja e eksperiencave më të mira të artistëve shqiptarë që jetojnë jashtë në skenat e vendit.***

- Përfaqësimi i Shqipërisë në Panair të rëndësishme Ndërkombëtare në fushën e librit.
- Krijimi i kalendarit të përbashkët Shqipëri – Kosovë.
- Pas 34 vjetësh trupa e baletit të Kosovës vjen në Tiranë me baletin, “Balloja e diplomës”, si një bashkëpunim mes Kosovës dhe Shqipërisë.

- Shkup, Panairi i 26-të Ndërkombëtar i Librit 2014. Morrën pjesë autorët më në zë të letërsisë bashkëkohore shqipe.
- Pranvera e Fraknkofonisë
- Protokoll bashkëpunimi midis Ministrisë të Kulturës dhe Këshillit Britanik në Shqipëri.
- Rikthimi i balerinit Eris Nezha, balerin solist në Boston Ballet's. Ai erdhi në skenën shqiptare me baletin Giselle.
- Rikthimi madhështor i Sopranos Ermonela Jaho, në skenën shqiptare me "Madam Butterfly".